



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:022356

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06220384

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Florid Hasku, me bashkëpunëtorin profesional Senad Telaku, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve H. H., M.D., P.K., dhe R.M. që të gjithë nga Gjakova, të cilët me autorizim i përfaqëson Arbër Guta avokat në Prishtinë, me adresë në rrugën “Robert Doll”, nr. 19, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, të cilin me autorizim e përfaqëson Valdete Rudi – juriste, me objekt kontesti: kompensim i pagës së 13-të, jashtë seancës, me 26 shtator 2024, mori këtë;

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësve H. H., M.D., P.K., dhe R.M. që të gjithë nga Gjakova, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, që në emër të pagës së 13-të (trembëdhjetë), paditësve H. H. në vlerë të një page mujore t’ia paguaj shumën prej 377.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,131.00 euro, M.D. në vlerë të një page mujore t’ia paguaj shumën prej 471.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,413.00 euro, P.K. në vlerë të një page mujore t’ia paguaj shumën prej 471.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,413.00 euro, dhe R.M. në vlerë të një page mujore t’ia paguaj shumën prej 377.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,131.00 euro, që të gjitha këto me kamatë prej 8% nga data e paraqitjes se padisë e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësit përmes së autorizuarit të tyre me datë 26.12.2024, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi në të cilën kanë theksuar se paditësit janë në marrëdhënie të punës së rregulltë tek e paditura, me kontratë në kohë të pacaktuar me detyrat si Infermiere në Repartin e Sëmundjeve të Brendshme këtu paditësja e parë H. H., paditësja e dytë M.D. si Infermiere kryesore në Shërbimin e Kujdesit Intensiv, paditësi i tretë P.K. si Infermier në Repartin e Kirurgjisë, dhe paditësja e katërt R.M. si Infermiere e Përgjithshme. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, konkretisht nenin 17 paragrafi 2 paditësit kanë kërkuar nga e paditura si punëdhënëse që t'ua paguaj pagën e 13-të për punën e bërë për vitet 2020, 2021 dhe 2022. E paditura gjer më tani nuk e ka kryer obligimin e saj të dalur nga KKS-ja. Me propozim për gjykatën që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësve, ashtu që ta detyroj të paditurën që në emër të pagës së 13-të, për paditësen e parë H. H. në vlerë të një page mujore t'ia paguaj shumën prej 377.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,131.00 euro, për paditësen e dytë M.D. në vlerë të një page mujore t'ia paguaj shumën prej 471.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,413.00 euro, për paditësin e tretë P.K. në vlerë të një page mujore t'ia paguaj shumën prej 471.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,413.00 euro, dhe për paditësen e katërt R.M. në vlerë të një page mujore t'ia paguaj shumën prej 377.00 euro për vitet 2020, 2021 dhe 2022 apo shumën e përgjithshme prej 1,131.00 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcenim të përmbarrimit.

E paditura, përmes së autorizuarës së saj me datë 16.09.2024 në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, në të cilën ka theksuar se e kundërshtojmë kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, të parashkruar dhe të pathemeltë. Tutje ka theksuar se padisë së paditësve iu mungon baza ligjore, pasi bëhet fjalë për kontratën kolektive sektoriale të shëndetësisë, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 e deri më datë 10.06.2021. Ka theksuar se sipas dispozitës së nenit 17 paragrafi 2 të KKS-së, e njëjta interpretohet duke u lidhur me ekzistimin e mundësisë për një shpërblim të tillë, siç ka paraparë edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin juridik me numër protokollit 212/2023, të datës 09.10.2023, andaj edhe e paditura SHSKUK si organizatë buxhetore ka pasur mungesë të buxhetit ndër vite në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, edhe përkundër planifikimeve, e njëjta asnjëherë nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat në paga dhe mëditje, ku në tremujorin e fundit TM3 të çdo viti, vazhdimisht ka pasur deficit në paga dhe është plotësuar nga Ministria e Financave për mbulimin e pagave të rregullta, siç provohet edhe nga njoftimi i lëshuar nga Drejtori Financiar i SHSKUK z. Enver Gashi, me numër protokollit 3823, i datës 21.12.2023. Po ashtu, ka parashtruar se edhe Spitali i Përgjithshëm

“Isa Grezda” në Gjakovë, si institucion shëndetësor i nivelit sekondar/dytësor nuk ka mundësi buxhetore të bëjë kompensimin e shpërblimit për pagën e 13-të, siç provohet edhe nga përgjigja në kërkesë me numër protokolli 3610, e datës 13.12.2023, e lëshuar nga U. D. i shefit të njësise për buxhet dhe financa z. Murat Kursani. Me propozim për gjykatën që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 399 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK) erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar për arsyet si në vijim:

Në mes të palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësit janë të punësuar tek e paditura, përkatësisht në punët dhe detyrat si Infermiere në Repartin e Sëmundjeve të Brendshme këtu paditësja e parë H. H., paditësja e dytë M.D. si Infermiere kryesore në Shërbimin e Kujdesit Intensiv, paditësi i tretë P.K. si Infermier në Repartin e Kirurgjisë, dhe paditësja e katërt R.M. si Infermiere e Përgjithshme, po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësja e parë H. H. realizon pagë mujore bazë prej 377.00 euro, paditësja e dytë M.D. realizon pagë mujore bazë prej 471.00 euro, paditësi i tretë P.K. realizon pagë mujore bazë prej 471.00 euro, dhe paditësja e katërt R.M. realizon pagë mujore bazë prej 377.00 euro, tek e paditura.

Kontestuese në këtë rast në mes palëve ishte se a iu takon paditësve e drejta për kompensimin e pagës së 13-të dhe se a ekzistojnë mundësitë buxhetore tek e paditura për pagimin e pagës së 13-të, kundrejt paditësve.

Kjo gjykatë gjeti se në këtë rast duhet të aplikohet Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, e datës 12.06.2018, e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në aplikim nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2021, e cila në nenin 17 paragrafi 2 ka paraparë se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13-të (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Në vlerësim të dispozitës se cekur si me lart, kjo gjykatë vlerëson se dispozita nga neni 17 paragrafi 2 e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, në përmbajtje lidhet me mundësitë buxhetore të punëdhënësit, pra e njëjta dispozitë nuk është e karakterit detyrues, përjashtimisht

efektin detyruës e merr në rast se punëdhënësi ka buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e pagës së 13-të (trembëdhjetë) për punëtorët e punësuar dhe që janë nën menaxhimin e tij. Pra, kjo e drejtë krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbush këtë obligim, ndërsa nuk arrin që të provoj me asnjë provë se nuk ka pasur mundësi buxhetore për një kompensim të tillë.

Kësisoj, e paditura me rastin e paraqitjes së përgjigjes në padi, gjykatës i ka dorëzuar edhe provën materiale, nga e cila dëshmohet edhe gjendja financiare e saj në raport me buxhetin e pranuar vjetor për paga dhe mëditje.

Nga njoftimi me numër 3823, i datës 21.12.2023, i lëshuar nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, përkatësisht nga Drejtori Financiar z. Enver Gashi, vërtetohet se për vitin 2020, buxheti fillestar i alokuar për paga dhe mëditje për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, ka qenë në shumë prej 57,191,921.00 euro, ku buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 76,250,921.00 euro, ndërsa përfundimisht si institucion ka qenë në deficit buxhetor në shumë prej 19,059,000.00 euro, për vitin 2021 buxheti fillestar i alokuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 56,076,877.00 euro, ku buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 73,825,422.00 euro, ndërsa përfundimisht si institucion ka qenë në deficit buxhetor në shumë prej 17,748,544.00 euro, dhe për vitin 2022 buxheti fillestar i alokuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 62,757,261.00 euro, ku buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 70,231,105.00 euro, ndërsa përfundimisht si institucion ka qenë në deficit buxhetor në shumë prej 7,473,844.00 euro.

Pra, nga njoftimi i cekur më lartë, njoftim të cilin gjykata e vlerësoj të besueshëm dhe të plotë, marrë parasysh se i njëjti është i lëshuar po nga organi dhe personi kompetent lidhur me gjendjen buxhetore tek e paditura, u provua se mundësitë buxhetore të të paditurës nuk kanë qenë që e njëjta të veproj sipas dispozitës së nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë.

Andaj, gjykata kërkesëpadinë e paditësve në raport me pagën e 13-të (trembëdhjetë) për vitin 2020, e refuzoj për faktin se e paditura nuk ka qenë e obliguar për kryerjen e pagesave të sipërcituara, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Ndërsa, kërkesëpadinë për pagimin e pagës së 13-të (trembëdhjetë) në raport me vitin 2021 dhe 2022, gjykata e refuzoj për shkak se e njëjta kërkesë nuk kishte bazë ligjore, përkatësisht referuar aplikueshmerisë së Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, kjo gjykatë erdhi në përfundim se në kohën kur ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar një të

drejtë të cilën mendojnë se iu takon, kontrata e cekur si me lart nuk ka qenë në fuqi, pasi zbatimi i saj ka filluar me datë 11.06.2018, ndërsa përfundimisht ka përfunduar se zbatuari me datë 10.06.2021.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore ta vendos jashtë seancës gjyqësore duke u mbështetur në nenin 399 të LPK-së, e cila parasheh që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, si dhe duke u bazuar në praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (rasti Jussia kundër Finlandës, nr.73053/01), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës, obligim i cili del nga neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2959/23, me 26 shtator 2024

Gj y q t a r i

Florid Hasku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.